



Pranuar / Dorezuar Priliceno / Priliceno Received / Delivery	18.10.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org. Unit	SKAMSHICK	6282/2022	1/4
Nr Prot Bil Prot Prot No			
Shifra Protog Uppendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.764/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti -kryetar,Malsore Gashi - Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj - Demi -anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.764/2022 të datës 05.09.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.10.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.764/2022, e datës 05.09.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET NË FUQI, Vendimi i datës 29.08.2022, me numër të referencës 07/1-01SAP-R/579/2022 i Drejtorisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 05.09.2022, me numër protokolli 5128/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me Nr.të Referencës; 07/1-01SAP-R/579/2022, të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Auditor i Brendshme”, lëvizje brenda kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (më tej KPMSHCK-ja) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 15.09.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorie, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 764/2022 të datës 05.09.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 29.08.2022, Nr. i Referencës; 07/1-01SAP-R/579/2022, të Drejtorisë së Personelit të Policisë së Kosovës; Kërkesë për fillimin e procedurës së rekrutimit e datës 20.05.2022; Konkursi i datës 20.07.2022, për lëvizje brenda kategorisë; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i A.S-P, me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 12.06.2017; Diplomë e datës 31.10.2013, me numër 3633; Diplomë e datës 24.01.2017, me numër 1078; Certifikatë e datës 26-29, e muajit janar të vitit 2017; Certifikatë e datës 30.07.2012; Certifikatë e datës 07-08.2012; Akt Emërimit e datës 03.04.2012; Kontratë e punës e datës 01.06.2022; Akt Emërimi i datës 25.07.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në Punë për A.S; Vendimi i datës 17.08.2020, për pushim të lehonisë; Vërtetim i datës 10.02.2020; Vendimi i datës 18.08.2022, me numër protokoll referencë 07/1-01SAP- R/558/2022, i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës; Njoftimi i datës 18.08.2022, me numër referencë 07/1 -01SAP-R/560/2022, i Drejtorisë së Policisë së Kosovës; Ankesë e datës 24.08.2022, drejtuar Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës; Përgjigjen në ankesë e datës 15.09.2022, me numër protokoll 5421/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuses *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht konkursit me numër RN00009431, të datës 20.07.2022 për pozitën "Auditor i Brendshëm" 'në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me rastin e aplikimit si kushte të përgjithshme formale kanë qenë :*Arsimimi i kërkuar: Diplome Universitare; me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master, të jetë e njëjte apo vazhdim (specializim) i diplomës Bachelor), në Ekonomi, Administratë Publike, Financa Publike, Kontabilitet apo Juridik, Kualifikime të posaçme formale: Certifikatë e Auditorit të Brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave, ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevantë ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa në kuadër të kërkesave të veçanta kanë qenë :*të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori, të jetë nëpunës i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale, të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë mase disiplinore që nuk është shuar ende, të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë për dy vitet e fundit, në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit, rrjedhimisht me rastin e dorëzimit të dokumentacionit ka qenë dashtë të dorëzohen specifikisht edhe këto dokumente të parapara në kuadër të kriterëve të konkursit që janë paraparë tek kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta që lidhen me këtë konkurs.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në specifikat e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të konkursit të atakuar me këtë ankesë, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses të paraqitur përmes ankesës së saj në Këshill lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Auditor i Brendshëm“, Përkatësisht refuzimin e aplikacionit të saj për këtë pozitë, ka konstatuar se ankuesja deri më datë 22/07/2022 ka qenë në marrëdhënie të punës në Polici të Kosovës ndërsa nga data 25/07/2022, ka filluar punën në Ministri të Financave-Thesarin e Kosovës përmes konkursit lëvizje brenda kategorisë, ndërsa e njëjta më datë 09/08/2022 ka dorëzuar aplikacionin RAN0006756, pra në kohën kur ka dorëzuar aplikacionin e punësimit ka qenë e punësuar në Thesarin e Kosovës e që rrjedhimisht mbi bazë të kriterëve të konkursit ka qenë obligim për dorëzimin përveç tjerash edhe të dokumentit që konfirmohet se e njëjta nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi dhe mbi këtë bazë Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 18.08.2022 me numër të referencës 07/1-01SAP-R/558/2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses ndërsa ankuesja është ankuar ndaj këtij vendimi dhe Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës duke shqyrtuar këtë ankesë ka nxjerrë Vendimin e datës 29.08.2022 me numër të referencës 07/1-01SAP- R/579/2022 me që rast ka refuzuar aplikacionin e ankueses për tu përfshirë në listën e ngushtë, me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret e konkursit të brendshëm lëvizje brenda kategorisë të shpallur nga data 04/08/2022 deri më datë 11/08/2022, nga se e njëjta nuk ka paraqitur dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim: *“Dokumentin që dëshmon se nuk ka ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende nga institucioni ku është punësuar”* mbi këto arsye ka vepruar në pajtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.... 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve...”*.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lart cekura konstatohet se Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, bazuar në kompetencat e përcaktuara dhe me nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 dhe paragrafin 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve dhe përmes vendimit të datës 18.08.2022 me numër të referencës 07/1-01SAP-R/558/2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses ndërsa ankuesja është ankuar ndaj këtij vendimi dhe Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës duke shqyrtuar këtë ankesë ka nxjerrë Vendimin e datës 29.08.2022 me numër të referencës 07/1-01SAP- R/579/2022 me që rast ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak të mos plotësimit të kriterëve për pozitën e lartcekur dhe mbi këtë bazë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses për pozitën, “Auditor i Brendshëm” në Policin e Kosovës, konkurs i shpallur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.764/2022, datë 18/10/2022

**Rushit KAJTAZI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.